# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449076**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Avokati i Rexhep Selimit pas dënimit të ish-kreut të UÇK-së me 13 vjet burgim: Jemi shumë të zhgënjyer me aktgjykimin - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/avokati-i-rexhep-selimit-pas-denimit-te-ish-kreut-te-uck-se-me-13-vjet-burgim-jemi-shume-te-zhgenjyer-me-aktgjykimin/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 12:05:32 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 12:03:44 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a4ad52419921253f4be956a259fb7e49463dc3a084eed3b7e6c28d56ebef5253` |
| TEKSTI | `e8476d2310169500ddb52d636bfeb2f2e0896ab7f8decfd12bfaad5b3910fa47` |
| PAMJA | `98ce84043b2a1b301b0e2a24ddcaf4c3e2209bcef4bfd0af932910f834bba92e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e024e3c1f721b69e98c6ca6a3621f36d875bc85f4521e70225b4c93bb5c268a9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e024e3c1f721b69e98c6ca6a3621f36d875bc85f4521e70225b4c93bb5c268a9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | RAJONI

# Avokati i Rexhep Selimit pas dënimit të ish-kreut të UÇK-së me 13 vjet burgim: Jemi shumë të zhgënjyer me aktgjykimin

16 Shtator 2026 | 14:03

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Mbrojtja e Rexhep Selimit, e udhëhequr nga avokati Geoffrey Roberts, ka reaguar pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, me të cilin Selimi u dënua me 13 vjet burgim.

Në një deklaratë të shkurtër për media, Roberts tha se mbrojtja është e zhgënjyer me vendimin, por theksoi se bëhet fjalë për aktgjykim të shkallës së parë.

“Jemi shumë të zhgënjyer me aktgjykimin, por është shumë e rëndësishme të theksohet se kjo është vetëm faza e parë, beteja e parë, si të thuash. Z. Salimi synon plotësisht t’i ushtrojë të drejtat e tij për ta apeluar këtë aktgjykim përmes kuadrit ligjor të Kosovës dhe ne jemi të bindur se në fund, përfundimisht, ai do të shpallet i pafajshëm për të gjitha këto akuza”, ka thënë ai.

I pyetur për gjendjen e Selimit pas shpalljes së aktgjykimit, Roberts tha se kishte takuar klientin e tij dhe kishte diskutuar me të për vendimin, por nuk pranoi të japë detaje të tjera.

“Më vjen keq, nuk do të pranoj pyetje. Jam takuar me z. Selimi dhe kemi diskutuar për aktgjykimin, por nuk do të jap më shumë detaje”, tha Roberts.

**Shiko në:**

## LAJMI I FUNDIT

13:57 **Vendimi në Hagë, Daçiç: Aktgjykimi konfirmon pretendimet e Serbisë për UÇK-në**

13:47 **Vendimi në Hagë, Ali Ahmeti: E padrejtë, beteja vazhdon në apel**

13:40 **BE për dënimet e ish-krerëve të UÇK-së, thirrje për përmbajtje: Gjykata të lejohet të veprojë pa ndërhyrje**

13:40 **Limaj pas vendimit në Hagë: Aktgjykim i padrejtë, jo në emër të popullit të Kosovës**

13:38 **Avokati i Thaçit: I rashës kokës me grushte kur gjyqtari tha në emër të popullit të Kosovës**

13:28 **Gjendja e Unionit, pesë përfundimet kryesore nga fjalimi i Ursula von der Leyen**




## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

### Vendimi në Hagë, Daçiç: Aktgjykimi konfirmon pretendimet e Serbisë për UÇK-në

Zëvendëskryeministri dhe ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Serbisë, Ivica Daçiç ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të...

13:57 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

**Vendimi në Hagë, Ali Ahmeti: E padrejtë, beteja vazhdon në apel**

Kreu i BDI-së, Ali Ahmeti ka reaguar pas vendimit të marrë këtë të mërkurë në Hagë e cila dënoi me 81 vite burg në total...

13:47 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

**BE për dënimet e ish-krerëve të UÇK-së, thirrje për përmbajtje: Gjykata të lejohet të veprojë pa ndërhyrje**

Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje të gjitha palëve në Kosovë dhe në rajon që të tregojnë përmbajtje pas aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit,...

13:40 | 16/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.